

VENDIM
Nr.26, datë 19.7.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Hilmi Dakli,	Anëtar i“““
Manol Konomi,	Anëtar i“““
Veli Budo,	Anëtar i“““
Zija Vuci,	Anëtar i“““
Alfred Karamuco,	Anëtar i“““
Ha1il Kopani,	Anëtar i“““
Kristofor Peci,	Anëtar i“““

me sekretare Drita Filto, më datën 10.7.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.35 Akti që i përket:

KËRKUESE: PARTIA SOCIALDEMOKRATE. e përfaqësuar nga Z.Gaqo Apostoli dhe Av.Muharrem Kushi.

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga sekretari, Z. Thimjo Kondi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zonën 34 në bazë të nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4. 2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor" (me ndryshimet).

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi kërkesin, subjektin e interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me ankimin e paraqitur në Gjykatë, Partia Socialdemokrate ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të komisionit të zonës nr.34 dhe shpalljen të paligjshme të zgjedhjeve në këtë zonë, ku ka fituar kandidati i Partisë Demokratike.

Kërkesa e Partisë Socialdemokrate i konsideron të paligjshme zgjedhjet në zonën nr.34 për shkak të manipulimeve dhe falsifikimeve të procesverbaleve të votimit. Kërkuesi nuk paraqiti ndonjë provë për të vërtetuar pretendimet që parashtron

Gjykata konstaton se procesverbalet e qendrave të votimit dhe ai i zonës janë të rregullt, ato nuk përmbajnë asnjë vërejtje për parregullsi gjatë votimit. Procesverbalet e qendrave të votimit të paraqitura nga kërkuesi janë të njëjta me ato që janë marrë në shqyrtim nga komisioni.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 e 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor", njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 19. 7.1997